

VENDIM
Nr.68, datë 2.2.2011

**PËR MIRATIMIN E FONDIT LIMIT TË SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
RADIOS DHE TELEVISIONIT, PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2011, në shumën 89.07 (tetëdhjetë e nëntë pikë zero shtatë) milionë lekë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ndarë, si më poshtë vijon:

- a) Për shpenzime korente, 77.06 (shtatëdhjetë e shtatë pikë zero gjashtë) milionë lekë;
- b) Për shpenzime për investime, 12.01 (dymbëdhjetë pikë zero një) milionë lekë.

2. Fondi i parashikuar sipas pikës 1 të vendimit, të përballohet nga të ardhurat e realizuara të vitit 2011, nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit.

3. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

**DETAJIMI I FONDIT LIMIT TË SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVISIONIT PËR VITIN 2011**

<i>Në mijë lekë</i>		
Nr.	Emërtimi	
1	Paga	49 000
2	Sigurime shoqërore	7 300
3	Shpenzime korente të tjera	20 760
4	Investime	12 010
	Shpenzime totale	89 070